

FM STONE



PERSHKRIMI

Ngjitës me bazë çimento fleksibël për ngjitjen e pllakave të gurëve natyral.

KLASIFIKIMI I PRODUKTIT

FM Stone është klasifikuar si c2te sipas en 12004, baza c çimento, 2 ngjitës me forcë ngjitëse të lartë, t rezistenca ndaj rrëshkitshmërisë, e kohe e zgjatur e punimit.

KARAKTERISTIKAT

- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.
- Për zonat e thatë dhe me lagështi.
- Punueshmëri e mirë.
- Për fiksimin e pllakave të gurëve natyral në dysheme dhe fasada.

FUSHA E PËRDORIMIT

FM Stone përdoret për shtrimin e pllakave qeramike, te gurit natyral me dimensione te ndryshme në sipërfaqe të ndryshme të tilla si: beton, veshje izoluese, çimento, suva, pllaka të vjetra, etj. Ky produkt është i përshtatshëm për brenda dhe jashtë. FM Stone gjithashtu mund të aplikohet në sipërfaqe të deformueshme si pllaka gipsi, druri, apo dysheme me ngrohje qendrore nëse përforcohet me adetivin flexit, adetiv që përmirëson parametrat teknike të ngjitës.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Pluhur
Ngjyra:	Bardhe / Gri
Sasia e ujit per hidratim:	7 l/25 kg bag
Temperatura e aplikimit:	nga +50C deri ne +350C
Spesori aplikimit:	deri ne 30 mm
Koha e punimit:	te pakten 5 ore
Koha e punueshmerise:	35 min
Rreshkitshmeria:	0,2 mm
Mbushja e fugave ne mure:	pas 8 oresh
Mbushja e fugave ne dysheme:	pas 24 oresh
Forca ngjitese pas 28 ditesh ne:	
• Kushte normale:	≥ 1,73 N/mm2
• Veprimin e nxehtesisene +70°C:	≥ 1,63 N/mm2
• Zhytjen ne uje:	≥ 1,59 N/mm2
• Ciklet ngirje shkrirje:	≥ 1,56 N/mm2
Rezistenca temperatuore:	nga -300C ne +900C

PREGATITJE E APLIKIMIT

Suportet tradicionale me bazë çimento duhet të kenë një kohë maturimi të mjaftueshme prej (28 ditë në temperaturë 23°C dhe u.R 40%). Suportet duhet të jenë të sheshta dhe të qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit. Suporti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i pastër e pa lëndë të huaja të tilla si: bojra, vajra, verniqe, material anti-ngjitëse. Pastrimi bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Suvatë përpara aplikimit të produktit duhet të kenë një maturim të paktën 1 javë. Suportet duhet të jenë mekanikisht të qëndrueshëm në funksion të qëllimit të përdorimit. Sipërfaqja e suportit ku do të aplikohet produkti duhet të jetë e pastër nga çdo lloj lënde e huaj.

APLIKIMI

Për një aplikim sa më të mirë të produktit si dhe për të përfutur një shpërndarje të mirë dhe uniforme në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që fillimisht shtrimi i produktit mbi suport të bëhet me pjesën e drejtë të mallës, e më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Produkti duhet të aplikohet me një mallë të përshtatshme në varësi të tipit dhe përmasave të pllakës. Rekomandohet që mbas vendosjes së pllakës, të ushtrohet presion mbi të në mënyrë që pjesa e pasme të laget plotësisht. Në kushte të veçanta si: temperaturat e larta apo erërat e forta, dielli apo substrate me një absorbim të lartë të ujit që ndikojnë negativisht në performancën e produktit madje mund të ulin në mënyrë të ndjeshme kohën e hapjes dhe të korrektimit, ndaj për të mënjeluar probleme të tilla rekomandohet që suporti të spërkatet me ujë përpara aplikimit të ngjitësit ose të trajtohet me astarin dw primer. Gjithsesi në çdo rast është e rëndësishme që përpara shtrimit të pllakës të kontrollohet nëse ngjitësi ka formuar cipë. Në një rast të tillë duhet të bëhet një rishpërndarje e ngjitësit për të riaktivizuar forcën ngjitëse të tij. Duhet shmangur derdhja e ujit mbi ngjitësin që ka krijuar cipë (është ngurtësuar) sepse në një rast të tillë formohet një shtresë antingjitëse. Në rastin e veshjeve dhe dysHEMEVE në ambiente të jashtme sidomos në rastet kur pjesa e pasme e pllakave është me relief këshillohet që ngjitësi të përhapet edhe në pjesën e pasme të places edhe në suport në mënyrë që të mos krijohen zgavra (kavitete) në të cilat mund të penetrojë uji apo të formohet lagështi e cila mund të shkaktojë më pas shqitjen ose edhe thyerjen e pllakave.

RUAJTJA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin e tij origjinal dhe të mbyllur, në zona të mbrojtura nga dielli dhe ngricat.

KONSUMI

4- 5 kg/m²

PAKETIMI

25 kg

